



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.68

21 maj

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9913 datë 5.5.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar ... 2899
Udhëzim i MBUMK nr.5, datë 13.5.2008	Për zbatimin e kritereve të vlerësimit dhe shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve të marra nga përdoruesi, si dhe makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit gjendje në magazinën e projektit “Rritja e prodhimit udhëqimor 2KR”, të ardhura grand nga Japonia” 2996
Udhëzim i MPPTT nr.5, datë 29.4.2008	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” 3004
Udhëzim i MPPTT nr.6, datë 29.4.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” 3007

LIGJ
Nr.9913, datë 5.5.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 15 ndryshohet si më poshtë:

“15. “Prodhuës i pavarur i energjisë elektrike” është prodhuësi jopublik, i lidhur drejtpërdrejt në sistemin e transmetimit.”.

2. Pika 25 ndryshohet si më poshtë:

“25. “Shpërndarja” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë (nënstacionet 110 kV), të mesëm dhe të ulët, deri te klienti i fundit, por që nuk përfshin furnizimin.”.

3. Pika 26 ndryshohet si më poshtë:

“26. “Operator i Sistemit të Shpërndarjes” është personi përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.”.

4. Pika 29 ndryshohet si më poshtë:

“29. “Hyrja e palëve të treta” është e drejta e të gjithë prodhuesve, tregtuesve, furnizuesve dhe përdoruesve të energjisë elektrike, për të përdorur rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas rregullave dhe tarifave të përcaktuara në aktet e tjera ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të energjisë elektrike.”.

5. Pika 30 ndryshohet si më poshtë:

“30. “Furnizim” është shitja dhe blerja për rishitje te klientët e energjisë elektrike.”.

6. Në pikën 30/1 fjalët “Furnizuesi publik” zëvendësohen me fjalët “Furnizuesi publik me pakicë”.

7. Pas pikës 30/1 shtohet pika 30/2 me këtë përmbajtje:

“30/2. “Furnizuesi publik me shumicë” është personi i licencuar për blerjen e energjisë elektrike nga gjenerimi publik, nga PPE-të, PVE-të apo tregtuesit për shitjen te furnizuesi publik me pakicë.”.

8. Pika 38 ndryshohet si më poshtë:

“38. “Prodhuës i vogël i energjisë elektrike” është një prodhuës me kapacitet të instaluar, që është i lidhur drejtpërdrejt në sistemin e shpërndarjes.”.

Neni 2

Në nenin 8 pika 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënien, ndryshimin, transferimin dhe heqjen e licencave të shoqërive për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike;”.

2. Në fund të shkronjës “d” shtohen fjalët:

“sikurse përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore;”.

3. Në shkronjën “f”, pas fjalëve “monitoron dhe kontrollon” shtohen fjalët “kontratat dhe”.

4. Në shkronjën “l”, fjalët “kur e kërkon situata energjetike” hiqen.

Neni 3

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) prodhimin e energjisë elektrike;”.

b) Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) furnizimin me shumicë ose me pakicë të energjisë elektrike;”.

c) Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) tregtimin e energjisë elektrike, brenda dhe jashtë vendit.”.

ç) Shkronja “dh” shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. ERE-ja i jep licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike vetëm një personi juridik.”.

3. Pika 5 shfuqizohet.

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për vetëprodhuesin, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik, nuk është i nevojshëm licencimi me licencë prodhimi.”.

Neni 4

Në nenin 14, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat e licencimit, në përputhje me këtë ligj, ku përcaktohen kriteret dhe kushtet për dhënien, ndryshimin, transferimin ose heqjen e licencës, si dhe pagesa, që duhet kryer për çdo tip aplikimi për licencë. ERE-ja miraton rregulloren për vendosjen e procedurave të thjeshta dhe të përshtatshme për licencimin e centraleve elektrike, të lidhura drejtpërdrejt në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.”.

Neni 5

Në nenin 16 pika 1, fjalia e fundit shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 18 pika 1, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) me kërkesën e të licencuarit.”.

Neni 7

Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo i licencuar mund të kërkojë ndryshim të licencës. ERE-ja mund të bëjë ndryshime të afateve dhe të kushteve të licencës, me kërkesë të të licencuarit, pasi të ketë vlerësuar efektet e

ndryshimit të propozuar, ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas këtij ligji dhe licencës së tij, si dhe me kusht që ndryshimet jo vetëm të jenë kërkuar me shkrim, por edhe të jenë pranuar nga i licencuari.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. ERE-ja kërkon ndryshimin e kushteve të një licence, kur ndryshon kuadri ligjor dhe nënligjor, që rregullon veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike.”.

Neni 8

Në nenin 20, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Asnjë i licencuar nuk mund ta transferojë licencën ose ndonjë aset të tij, që përdoret në veprimtarinë, për të cilën është licencuar, nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit ose formave të tjera, pa miratimin me shkrim të ERE-së.”.

Neni 9

Në nenin 22 pika 1 shkronja “a”, pas fjalës “transmetimit” shtohen fjalët “furnizimit publik, me shumicë dhe pakicë”.

Neni 10

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Mbajtja e bilanceve të llogarive

Çdo shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, e cila kryen më shumë se një nga veprimtaritë, që kanë të bëjnë me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin publik, me shumicë ose me pakicë, mban llogari të ndara për çdo veprimtari, në njësinë e vet të llogarive, si dhe përgatit bilance llogarish të konsoliduara, në përputhje me praktikën e kërkuar të llogarive. Këto shoqëri mbajnë, gjithashtu, llogari të ndara për veprimtaritë, që nuk lidhen me ato të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik, me shumicë ose me pakicë, të energjisë elektrike.”.

Neni 11

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Programet e investimeve

1. Të licencuarit, që kryejnë njërin prej veprimtarive të gjenerimit publik, të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik, paraqesin në ERE për miratim planet e tyre të investimeve për 3 vitet e ardhshme.

2. Të licencuarit, subjekte të pikës 1 të këtij neni, janë të detyruar të paraqesin në ERE, brenda datës 31 tetor të çdo viti, planet e përditësuara të investimeve për vitin pasardhës.

3. Për ata të licencuar, që aplikojnë për tarifë, për një periudhë rregullatore më të madhe se një vit, plani i investimeve duhet të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.

4. ERE-ja harton dhe miraton, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planeve të investimeve.”.

Neni 12

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Autoriteti i ERE-së për vendosjen e tarifave

1. ERE-ja është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara, që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

2. ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për procedurat dhe standardet, sipas së cilës përcaktohen, miratohen, ndryshohen ose refuzohen tarifat, afatet dhe kushtet e shërbimeve të energjisë elektrike.

3. ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për mënyrën e përcaktimit të pagesave për detyrimet e shërbimit publik, si dhe për procedurat e shpërndarjes së drejtë të kostove të detyrimeve të shërbimit publik tek të gjithë klientët e blerjes me pakicë të energjisë elektrike.

4. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton rregulloret e përcaktuara në pikat 2 e 3 të këtij neni.”.

Neni 13

Neni 29 shfuqizohet.

Neni 14

Në nenin 33, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo shoqëri, që kryen veprimtarinë e prodhimit, të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike duhet t'i mbajë llogaritë financiare të ndara, për secilën prej këtyre veprimtarive.”.

Neni 15

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 34/1

Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese

1. Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese, kur nuk është miratuar me një kontratë koncesionare, bëhet me miratimin e Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton një rregullore për procedurat dhe kriteret e dhënies së lejeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Kriteret për dhënien e lejeve marrin parasysh:

a) sigurinë e sistemit elektroenergjetik;

b) mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së publikut;

c) mbrojtjen e mjedisit;

ç) përdorimin e tokës;

d) efikasitetin e energjisë;

dh) llojin e burimit parësor të energjisë;

e) karakteristikat e aplikuesit për aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare.

4. Këshilli i Ministrave, me miratimin e lejes për ndërtimin e një burimi të prodhimit të energjisë elektrike, kur e sheh të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë që një pjesë e prodhimit t'i shitet furnizuesit publik me shumicë, me çmime të rregulluara nga ERE-ja, për nevoja të klientëve tariforë.”.

Neni 16

Në nenin 39, pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4 me këtë përmbajtje:

“3. Këshilli i Ministrave autorizohet të ndërmarrë nisma nxitëse dhe mbështetëse për ndërtimin e centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme, për prodhimin e energjisë elektrike, që do të konsumohet tërësisht brenda vendit.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë mekanizmat e nxitjes së ndërtimit të centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme, përfshirë edhe përcaktimin e masës së incentivave për ndërtimin e këtyre centraleve.”.

Neni 17

Në nenin 41, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike:

- a) garanton kapacitetin afatgjatë të sistemit, për të përballuar kërkesën e arsyeshme të transmetimit të energjisë elektrike;
- b) kontribuon në sigurinë e furnizimit, nëpërmjet kapacitetit të duhur të transmetimit, si dhe të besueshmërisë së sistemit;
- c) menaxhon flukset e energjisë së sistemit, duke marrë parasysh edhe shkëmbimet me sistemet e tjera;
- ç) siguron disponibilitetin e të gjitha shërbimeve ndihmëse të nevojshme, në një masë të tillë, që ky disponibilitet të jetë i pavarur nga çdo sistem tjetër transmetimi, me të cilin është i ndërlidhur;
- d) i siguron çdo operatori tjetër të transmetimit, të lidhur me të, informacion të mjaftueshëm, për të garantuar funksionimin e sigurt dhe eficient, zhvillimin e bashkërenduar dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve të ndërlidhura;
- dh) garanton mosdiskriminimin e përdoruesve të veçantë ose të kategorive të përdoruesve të sistemit të transmetimit;
- e) u ofron përdoruesve të sistemit informacion të mjaftueshëm për një hyrje eficiente në sistem;
- ë) operon linjat tregtare të interkonjeksionit.”.

Neni 18

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

1. Rrjeti i shpërndarjes zotërohet dhe operohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që ka një licencë për kryerjen e veprimtarisë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

- a) mban një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient, duke respektuar kushtet mjedisore;
- b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të parashikimeve të ndryshimit të kërkesës në vend;
- c) lidh të gjithë klientët ose prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, sipas dispozitave të kodit të shpërndarjes;
- ç) u siguron përdoruesve të sistemit të drejta të njëjta dhe pa diskriminim hyrjeje në rrjetin e shpërndarjes;
- d) u siguron përdoruesve të sistemit informacionin e nevojshëm për hyrjen dhe operimin eficient në rrjetin e shpërndarjes;

dh) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, që merr gjatë kryerjes së veprimtarisë;

e) siguron shërbime të tjera, të nevojshme për klientët, për të përmbushur detyrimet, sipas këtij neni.

3. Funksionet për kryerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve, të lidhur në sistemin e shpërndarjes, përmbushen nga furnizuesi publik me pakicë.”.

Neni 19

Në nenin 44, pika 4 shfuqizohet.

Neni 20

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 45

Veprimtaritë e furnizimit me energji elektrike

1. Furnizimi i klientëve tariforë kryhet nga furnizuesi publik me pakicë, me tarifa të rregulluara nga ERE-ja.
2. Furnizuesi publik me pakicë e siguron energjinë elektrike për furnizimin e klientëve tariforë nga furnizuesi publik me shumicë.
3. Furnizimi i klientëve të kualifikuar kryhet nga furnizuesit e kualifikuar, sipas kushteve të marrëveshjeve dypalëshe, për të cilat ata kanë rënë dakord.
4. Licenca e furnizuesit të kualifikuar nuk jepet në bazë monopoli dhe me të drejta ekskluzive.”.

Neni 21

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve

1. Furnizuesi publik me shumicë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
 - a) blen energji elektrike nga gjenerimi publik, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe tregtuesit, për nevojat e klientëve tariforë;
 - b) shet energji elektrike me tarifa të rregulluara te furnizuesi publik me pakicë;
 - c) shërben si furnizues i alternativës së fundit për të gjitha kategoritë e klientëve;
 - ç) zbaton kushtet e licencës së furnizimit publik me shumicë;
 - d) përmbush të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.
2. Furnizuesit me pakicë kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a) zbatojnë kushtet e licencës së furnizimit me pakicë të klientëve;
 - b) plotësojnë kërkesat e klientëve për energji elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës;
 - c) marrin pagesat që u takojnë, sipas kontratave;
 - ç) blejnë energjinë elektrike, që u nevojitet për të furnizuar klientët;
 - d) kanë të drejtë hyrjeje në rrjet, siç përcaktohet nga ky ligj dhe nga rregulloret e tjera, të miratuara nga ERE-ja;
 - dh) lexojnë matësat dhe lëshojnë faturat e konsumit të energjisë elektrike për klientët e tyre;
 - e) përmbushin të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.”.

Neni 22

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Matja e energjisë elektrike të furnizuar

1. Energjia elektrike e përdorur nga klienti lexohet dhe faturohet nga furnizuesi, sipas regjistrimeve të aparateve matëse.
2. Blerja, instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me shpenzimet e vetë operatorit. ERE-ja është e autorizuar t'i kërkojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të kryejë kontrollin e aparateve matëse për çdo kategori klientësh.
3. Kur klienti dyshon në saktësinë e një matësi, ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, kërkon nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të kontrollojë matësin. Kur edhe pas verifikimit klienti e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë kontrollin e matësit nga një organ i autorizuar, duke njoftuar

për këtë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Kur pas kontrollit vërehen pasaktësi, shpenzimet për riparimin ose zëvendësimin e matësit janë në ngarkim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Kur nuk vihet re ndonjë pasaktësi, shpenzimet e kontrollit paguhet nga klienti.

4. Çdo ndërhyrje tjetër në matës është e ndaluar dhe ndëshkohet sipas akteve ligjore në fuqi.”.

Neni 23

Në nenin 52, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të pajisë me sistem matjeje çdo klient të lidhur në sistemin e shpërndarjes.”.

Neni 24

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53

1. ERE-ja harton dhe, pasi merr mendimet e pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë elektrike, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për energjinë, modelin e tregut të energjisë elektrike.

2. Modeli i tregut të energjisë elektrike merr parasysh kërkesat e direktivave të BE-së për energjinë, si dhe çdo angazhim tjetër ndërkombëtar, të ndërmarrë nga vendi ynë.

3. Këshilli i Ministrave vlerëson propozimin e ERE-së dhe miraton modelin e tregut të energjisë elektrike.”.

Neni 25

Në nenin 55 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “dhe i miraton ato”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5731, datë 19.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

UDHËZIM

Nr.5, datë 13.5.2008

**PËR ZBATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE SHITJES SË TRAKTORËVE,
MAKINERIVE E PAJISJEVE TË MARRA NGA PËRDORUESI, SI DHE MAKINERIVE,
PAJISJEVE E PJESËVE TË KËMBIMIT GJENDJE NË MAGAZINËN E PROJEKTIT
“RRITJA E PRODHIMIT USHQIMOR 2KR”, TË ARDHURA GRAND NGA JAPONIA”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.371, datë 27.3.2008 “Për kriteret e vlerësimit dhe shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve të marra nga përdoruesit, si dhe makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit gjendje në magazinën e projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, të ardhura grand nga Japonia”,

UDHËZOJ:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shitja e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve bëhet me ankand.
2. Ankandi bëhet i hapur për çdo mall ose grup mallrash.
3. Procedura e shitjes duhet të garantojë të drejtën e konkurrencës së lirë e të barabartë ndërmjet blerësve, duke mos lejuar diskriminimin e konkurrentëve, administrimin e mirë dhe rigoroz të mallit të vënë në dispozicion.

KREU II AUTORITETI PËRGJEGJËS

1. Njësia e menaxhimit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” është autoriteti përgjegjës për përgatitjen dhe zhvillimin e ankandit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” organizon, drejton ankandin dhe lidh kontratat me përfituesit.

KREU III PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Projekti 2KR përcakton listën e traktorëve, makinerive dhe pjesëve të këmbimit që do të dalin për shitje me ankand, harton dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e ankandit, kërkesat për kualifikim dhe dokumentacionin për pjesëmarrësit.

2. Për përcaktimin e vlerës së fillimit të ankandit ngrihet komisioni i vlerësimit.

3. Me propozim të drejtorit të projektit 2KR, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit miraton komisionin e vlerësimit, i cili përcakton vlerën e fillimit të ankandit për çdo traktor, makineri e pajisje. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të institucioneve publike ose private, nga ku 1 (një) anëtar të jetë inxhinier mekanik, 1 (një) anëtar të jetë ekonomist dhe 1 (një) specialist bujqësie. Specialistët e sektorit shtetëror të angazhuar në këtë komision do të paguhen për kryerjen e veprimtarive dytësore sipas akteve nënligjore në fuqi, ndërsa për specialistët nga sektori privat do të lidhet kontrata e shërbimit e mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

4. Projekti 2KR vë në dispozicion të komisionit të vlerësimit, listën e traktorëve, makinerive dhe pjesëve të këmbimit që do të vlerësohen dhe shiten, si dhe të gjithë informacionin e kërkuar prej tij.

5. Komisioni i vlerësimit për llogaritjen e vlerës së fillimit të shitjes me ankand mbështetet në vlerën fillestare të kontabilitetit, orët e punës dhe gjendjen aktuale teknike në momentin e vlerësimit, për çdo traktor, makineri dhe pajisje. Në përcaktimin e çmimit të fillimit të ankandit, bazohet edhe në ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, në çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Komisioni ka përgjegjësi për përcaktimin e saktë të çmimit të fillimit të ankandit për çdo traktor, makineri apo pajisje.

6. Komisioni i vlerësimit i propozon për miratim Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit vlerën e fillimit të shitjes me ankand për çdo traktor, makineri apo pjesë të vlerësuar më parë dhe për çdo mall që përcaktohet duke llogaritur uljet e çmimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.371, datë 27.3.2008 “Për kriteret e vlerësimit dhe shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve të marra nga përdoruesit, si dhe makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit gjendje në magazinën e projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, të ardhura grand nga Japonia”.

KREU IV KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË ANKANDIT

1. Për shitjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve, krijohet komisioni i zhvillimit të ankandit. Drejtori i projektit 2KR i propozon Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngritjen e komisionit të zhvillimit të ankandit, të përbërë nga 5 (pesë) specialistë, 1 (një) kryetar dhe 4 (katër) anëtarë. Nga këta 1 (një) jurist, 1 (një) anëtar nga Ministria e Financave dhe 1 (një) nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Procedura e pagesës është e njëjtë me komisionin e vlerësimit të llogaritjes së çmimit të fillimit të ankandit.

2. Komisioni miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Komisioni i zhvillimit të ankandit për shitjen e mallrave ka për detyrë:
 - a) të evidentojë të gjithë blerësit për pjesëmarrje në ankand sipas kërkesave të tyre;
 - b) të deklarojë çmimin e fillimit të ankandit për çdo traktor, makineri e pajisje dhe pjesë këmbimi;
 - c) të deklarojë hapin e çmimit të ankandit;
 - d) të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga pjesëmarrësit;
 - e) të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë derisa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit;
 - f) të deklarojë që fituesi i ankandit të shpallet pjesëmarrësi, që ofron çmimin më të lartë;
 - g) në përfundim të dhënies së ofertave të shpallë fituesin, mbi bazën e ofertës më të lartë.
4. Të mbajë procesverbalin e ankandit, në të cilin duhet të jenë të pasqyruara përbërja e komisionit, pjesëmarrësit, dokumentacionin e paraqitur, kërkesat e tyre, si dhe çmimet e ofruara. Procesverbali i ankandit është i detyrueshëm për t'u firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

KREU V ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Drejtori i projektit 2KR nxjerr urdhrin për zhvillimin e ankandit, në të cilin përcaktohen dokumentacioni i kërkuar për pjesëmarrjen në ankand, data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit.
2. Publikimi i njoftimit për zhvillimin e ankandit bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike, 2(dy) herë radhazi, ku përcaktohen 2 (dy) data të zhvillimit të ankandit me një afat kohor jo më pak se 5 (pesë) ditë nga njëra-tjetra. Njoftimi botohet edhe në 2 (dy) gazeta kombëtare të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit publik. Data e zhvillimit të ankandit do të jetë jo më parë se 10 ditë nga dita e parë e botimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Botimi i parë i këtij njoftimi konsiderohet njoftim zyrtar.
3. Ankandi zhvillohet i hapur, çmimi i fillimit të ankandit të jetë:
 - a) për traktorët, makineritë dhe pajisjet e marra nga përdoruesit, ajo e përcaktuar nga komisioni i vlerësimit të çmimit të fillimit të shitjes me ankand dhe të miratuara nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - b) për makineritë, pajisjet dhe pjesët e këmbimit të pashitura, 75% më e ulët se vlera fillestare sipas kontabilitetit.
4. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar në njoftim dokumentacionin si më poshtë:
 - Për shitjet me lekë në dorë të mallrave:
 - a) dokumentin e identitetit, dokument që vërteton formimin e personalitetit juridik të subjektit fizik apo juridik;
 - b) kërkesën me shkrim për mallrat që kërkon të blejë;
 - c) sigurimin e ofertës për ankand: ky sigurim të bëhet vetëm në bankë, sigurimi i ofertës vërteton ngurtësimin për llogari të projektit 2KR të 10% të çmimit fillestar të shitjes për mallrat që kërkon të blejë në ankand. Afati i vlefshmërisë së sigurimit të ofertës është 40 ditë nga dita e zhvillimit të ankandit. Në rast të veçantë mund të kërkohet nga projekti 2KR të shtyhet afati i sigurimit të ofertës së ankandit në bankë;
 - Sigurimi i ofertës së ankandit u kthehet subjekteve, kur:
 - a) përfundon afati i sigurimit të ofertës për ankand;
 - b) anulohen procedurat e ankandit;
 - c) nuk shpallet fitues.
 - Kur subjekti shpallet fitues i ankandit, sigurimi i ofertës për ankand çngurtësohet vetëm në rastin kur lidhet kontrata mes palëve dhe kryhet pagesa e plotë e vlerës për të cilën është shpallur fitues.
5. Komisioni i zhvillimit të ankandit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit del me një vendim me shkrim, në të cilin përcakton fituesit e ankandit, sendet e blera dhe arsyet e skualifikimit të subjekteve të tjera. Komisioni i zhvillimit të ankandit miraton te drejtori i projektit 2KR vendimin dhe raportin përmbledhës të zhvillimit të procedurave duke pasqyruar ankesat, emrat e subjekteve fituese dhe mallrat e blera prej tyre. Pas miratimit të këtij raporti dhe kalimit të afatit 5

(pesë) ditor, njoftohen fituesit dhe botohet njoftimi i fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

6. Brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, subjekti fitues nënshkruan kontratën e shitjes me projektin 2KR.

7. Kur ofertuesi për arsye të ndryshme nuk nënshkruan kontratën brenda këtij afati dhe nuk kryen pagesën e plotë të vlerës së mallit ose mallrave të blera, projekti 2KR bën konfiskimin e sigurimit të ofertës për ankand. Projekti 2KR njofton ofertuesin e radhës në listën e ofertuesve të mbetur.

8. Në qoftë se pas kalimit të 10 ditëve nga shpallja e fituesve përfituesi nuk lidh kontratën e shitjes dhe nuk kryen pagesën e plotë të vlerës për të cilën është shpallur fitues, ai e humbet të drejtën e blerjes dhe sendi i propozohet për shitje ofertuesit të dytë ose rishpallet për shitje sipas procedurave të këtij udhëzimi. Në këtë rast sigurimi i ofertës për ankand prej 10%, që është ngurtësuar nga përfituesi i parë i ankandit është e pakthyeshme, kjo shumë kalon për llogari të projektit 2KR.

9. Kontrata e shitjes mes palëve nënshkruhet nga përfituesi dhe drejtori i projektit 2KR ose nga personi i autorizuar prej tij vetëm pasi të jetë paguar vlera e plotë e mallit ose e mallrave.

10. Tërheqja e mallrave nga pikat e magazinimit bëhet me autorizim, i cili lëshohet nga projekti 2KR vetëm pasi të jetë lidhur kontrata e shitjes dhe të jetë likuiduar vlera e plotë e mallit.

11. Kur nga zhvillimi i 4 (katër) procedurave të ankandit për çdo mall apo grup mallrash mbeten pa u shitur, projekti 2KR i propozon Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit uljen e çmimit fillestar të shitjes së mallrave, mbështetur në vlerësimin e Komisionit të vlerësimit çmimit. Ulja e çmimit deri në 50% miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Në këto raste zbatohen të gjitha procedurat e ankandit.

12. Në rastet kur edhe pas zhvillimit të procedurave të ankandeve mbeten pa u shitur traktorë, makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi dhe paraqiten kërkesa për blerjen e tyre apo pjesëve të veçanta, gjatë një periudhe 2-mujore, ato shiten pa ankand me komision shitjeje të ngritur nga projekti 2KR me çmimin e ankandit të fundit.

13. Komisioni i shitjes përcaktohet me urdhër të drejtorit të projektit 2KR brenda strukturës së këtij projekti. Komisioni i shitjes pajisjet me inventarin e traktorëve, makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit të pashitura, si dhe çmimet respektive të ankandit të fundit dhe zhvillon procedurat e shitjes së mallrave sipas kërkesave të paraqitura me çmimin e ankandit të fundit të publikuar.

14. Pas kalimit të periudhës 2 (dy) mujore, nëse ende ka mallra të pashitura, projekti 2KR njofton për gjendjen e mallrave institucionet shtetërore që konsiderohet se kanë interes për përdorimin e këtyre mallrave dhe në bazë të kërkesave dhe gjendjes fizike të mallrave të kryhet transferimi pa pagesë i këtyre mallrave, me miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të titullarit të institucionit përkatës përfitues.

15. Pas përfundimit të të gjitha këtyre procedurave të mësipërme, drejtori i projektit 2KR i propozon Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit sistemin e traktorëve, makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit të pashitura në magazinat shtetërore ose nxjerrjen jashtë përdorimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Përfituesit që kanë marrë traktorë, makineri, pajisje, të cilët kanë nënshkruar një kontratë shitjeje me këste dhe që aktualisht nuk kanë shlyer detyrimet sipas afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me projektin 2KR, mallrat u nënshtrohen procedurave ligjore të sekuestrimit apo të dorëzimit vullnetar të tyre. Shumat e derdhura deri në atë moment nuk do t'u kthehen.

2. Mallrat e sekuestruara apo të dorëzuara vullnetarisht sipas pikës 1 të këtij kreu, bëhen hyrje në magazinën e projektit 2KR. Rishitja e tyre realizohet nëpërmjet ankandit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Me urdhër të drejtorit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, pasqyrohen në kontabilitet diferencat financiare ndërmjet çmimit që është në kontabilitet dhe çmimit të shitjes së mallrave dhe si pasojë e transferimeve kapitale, të cilat kalojnë në pakësim të fondeve kundërparti të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”.

Udhëzimi nr.1, datë 9.11.2006 “Për zbatimin e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.148, datë 31.3.2000 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grand nga Japonia në kuadër të

projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”, shfuqizohet.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

ANEKSI NR.1

DOKUMENTET STANDARDE PËR PROCEDURAT E ANKANDIT TË PROJEKTIT 2KR

Përmbajtja:

1. Ftesa për ankand
2. Përshkrimi i objektit konkret të shitjes me ankand
3. Formulari i ftesës për ankand për konkurruesit fizikë/juridikë
4. Formulari i sigurimit të ofertës i lëshuar nga bankat

Komisioni i ankandit

Datë _____/200



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
PROJEKTI 2KR

Projekti "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" fton individët, personat fizikë e juridikë publik e private , për të marrë pjesë në ankandin për shitjen e _____ (lloji, sasia e mallit dhe të dhëna të përgjithshme mbi mallin në shitje).

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit pranë zyrës juridike të Projektit 2KR, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me adresë: "Sheshi "Skënderbej", nr.2 Tiranë, Tel: _____, Fax: _____, kundrejt një pagese prej _____ lekësh.

Hapja e dokumentacionit do të bëhet në datë _____ , ora _____ në adresën e mësipërme.

Për Projektin 2KR

Kryetari i komisionit të ankandit

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND
(Për konkurruesit, person fizik ose juridik, publik e privat)

_____, më datë _____

_____ me seli në _____ i
formuar si person juridik/fizik/me datë _____ me nr. NIPTI

_____ ushtron aktivitet

(emërtimi i personit fizik ose juridik)(adresa e plotë)

Pasi u njoh me dokumentet e ankandit që organizon projekti 2KR për shitjen e _____
(lloji i mallit), paraqet ofertën si më poshtë vijon:

Për objektin _____
Çmimi që ofrohet _____

(vlera në lekë me shifra dhe fjalë)
Vlefshmëria e kësaj oferte është _____ ditë

(numër e fjalë)

KONKURRUESI

(Emri i personit fizik ose juridik)

FORMULARI PËR SIGURIMIN E OFERTËS PËR PJESËMARRJE NË ANKAND

GARANCI BANKARE

Nr.ref. _____ datë _____

Me të cilën vërtetojmë se _____ (emri i subjektit), ka ngurtësuar në llogarinë e tij, pranë bankës _____, shumën prej _____ lekë si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur pranë projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” për pjesëmarrje në ankandin e shitjes _____ që do të zhvillohet në datën _____.

Banka _____ merr përsipër të kalojë shumën e ngurtësuar prej _____ lekë për llogari të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”;

në rast se:

1. Tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e ankandit.
2. Refuzimit për nënshkrimin e kontratës, kur autoriteti shitës kërkon një gjë të tillë.
3. Nuk paraqet garancinë bankare për sigurimin e kontratës.

Me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim pranë projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i një prej kushteve të mësipërme.

Banka _____ çliron garancinë bankare vetëm pas njoftimit me shkrim të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”, për llogari të së cilës është ngurtësuar shuma e mësipërme.

Kjo garanci bankare është e vlefshme deri më 30 ditë pas datës së zhvillimit të ankandit.

(Emri i bankës)

(Nënshkrimi dhe vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
PROJEKTI 2KR

Adresa: sheshi "Skënderbej", nr.2, Tiranë tel:+4 22 83 18; Fax: + 4 24 82 08

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 200 ____

VËRTETIM

I kalimit të pronësisë së _____

Z. _____ i shpallur fitues në ankandin e shitjes të bujqësore të ardhura në kuadër të projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR", ka shlyer në bazë të vërtetimit nr. _____ prot, datë _____ 200 ____ një shumë prej _____ lekë, të barabartë me fondin total të kontratës së _____ nr, _____, datë _____. Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____ datë _____ dhe në udhëzimin nr. _____ datë _____

Z./Znj. _____ i kalon pronësia mbi mallrat si më poshtë:

1. Mjet bujqësor _____, tipi _____, prodhim _____, viti i prodhimit _____, me numër shasie _____, fuqi _____.
2. Mjet bujqësor _____, tipi _____, Prodhim _____, viti i prodhimit _____, me numër shasie _____, fuqi _____.
3. Mjet bujqësor _____, tipi _____, Prodhim _____, viti i prodhimit _____, me numër shasie _____, fuqi _____.

UDHËZIM
Nr.5, datë 29.4.2008

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 6 ndryshohen si më poshtë:

“1. Transporti i brendshëm i udhëtarëve

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti në një linjë të rregullt qytetëse	licencë	bashkia
Transporti në linjë të rregullt rrethqytetëse	licencë	bashkia /komuna
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	licencë	bashkia
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	licencë	bashkia
Transporti i udhëtarëve me taks	licencë	bashkia
Agjenci transporti udhëtarësh e shërbimi taks	licencë	bashkia /komuna
Shërbimet e rastit	libër udhëtimi	qarku

2. Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transport ndërkombëtar udhëtarësh	licencë	ministria
Shërbimet në linjë të rregullt	autorizim	ministria
Shërbimet e rregullta të specializuara	autorizim	ministria
Shërbimet vajtje-ardhje (lavjerrës)	autorizim	ministria
	autorizim bilateral	ANALTIR
Shërbimet e rastit	libër udhëtimi	ANALTIR
	autorizim	ministria
Agjenci transporti udhëtarësh	licencë	bashkia

3. Transporti i mallrave brenda vendit

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për llogari të vet	certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	certifikatë	bashkia/komuna
Transporti me mjete jashtë norme	licencë	DPSHTRR

4. Transporti ndërkombëtar i mallrave

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	licencë	DPSHTRR
Transporti për llogari të vet	certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	certifikatë	DPSHTRR
Agjenci spedicionere	licencë	DPSHTRR
Transporti ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT	autorizim	ANALTIR

Neni 2

Paragrafi i fundit i nenit 7 ndryshohet si më poshtë:

“Shërbimet e rastit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve kryhen me anën e librit të udhëtimit/autorizimit, në bazë të marrëveshjes INTERBUS për shërbimet e rastit (për shtetet palë në këtë marrëveshje). Për shtetet e tjera ky shërbim kryhet në përputhje me marrëveshjet bilaterale.”.

Neni 3

Paragrafi i fundit i pikës 4 të nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“Licencat/autorizimet firmosen nga titullari i autoritetit kompetent që i lëshon, sipas nenit 6 të këtij udhëzimi, ose nga personat e autorizuar prej tij.

Data e lëshimit të licencës, autorizimit, lejes së operimit (autorizimit) dhe/ose certifikatës është data e nënshkrimit të tyre.”.

Neni 4

Në nenin 13 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Licencat për shërbimin taksi shtypen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Bashkitë mbajnë fotokopjen e licencës pas firmosjes nga titullari i institucionit, me qëllim depozitimin në praktikën e çdo subjekti të licencuar.”.

Neni 5

Pika 4 e nenit 15, ndryshohet si më poshtë:

“4. Vendimi i regjistrimit në gjykatë ose në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.”.

Neni 6

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

1. Për operim në linja të reja, të palicencuara ose për linja ku nuk operohet më, bashkia/komuna, nëpërmjet një komisioni vlerësues të emëruar nga kryetari i bashkisë/komunës, për zgjedh me konkurs të hapur subjektin, i cili në këtë rast, do të quhet kandidat për të operuar në një linjë të caktuar të rregullt udhëtarësh. Autobusët të jenë me targat e rrethit të bashkisë/komunës ku fillon linja.

Kriteret e përzgjedhjes përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak/komunal mbi bazën e kriterëve të licencimit të përcaktuar në nenin 8.

2. Bashkia/komuna bën monitorimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara në transportin ndërqytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve. Për mosplotësim të kushteve të licencimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë, bashkia/komuna njofton subjektin duke i lënë afat për plotësimin e tyre. Nëse

bashkia/komuna konstaton se subjekti nuk plotëson kushtet e licencimit të dokumentuara nga organet (Inspektorati i Kontrollit në rrugë pranë DPSHTRR, Polica Rrugore, organet tatimore), njofton subjektin dhe merr masa sipas nenit 9.

3. Bashkia/komuna ku fillon linja i kërkon zyrtarisht bashkisë/komunës së stacionit fundor të linjës miratimin e orareve të kthimit. Bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës është e detyruar të miratojë orare të përshtatshme të kthimit për subjektet e bashkisë/komunës ku fillon linja, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në rast të kundërt, autoriteti kompetent për lëshimin e licencës, pas 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përcakton oraret e kthimit, duke njoftuar bashkinë/komunën përkatëse.

4. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, subjekti transportues mund të ndërrojë e rifreskojë inventarin e autobusëve që operojnë në linjë, por gjithnjë brenda kriterit të numrit, gjendjes teknike të tyre dhe shenjës së targës të rrethit përkatës.”.

Neni 7

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Transporti ndërqytetës i udhëtarëve me autobus

Licenca për transportin ndërqytetës iu lëshohet vetëm personave juridikë.

Rrejtja e linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve të ndryshme dhe numri i orareve për linjat ndërqytetëse sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 25 të nenit 2 miratohen me urdhër të ministrit.

Rrjeti i linjave ndërqytetëse brenda një qarku dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut.

Licenca për linjat ndërqytetëse jepet nga kryetari i bashkisë, ku ka selinë subjekti transportues.

Subjekti i bashkëngjit formularit të autodeklarimit kontratën me agjenci të licencuar në bashkinë ku fillon linja, si dhe me agjencinë e udhëtarëve në stacionin fundor.”.

Neni 8

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Licenca për këtë veprimtari i lëshohet personave fizikë ose juridikë. Kamionët me kapacitet mbartës nën 1.5 ton nuk certifikohen për transport mallrash për të tretë dhe me qira.

Licenca për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira jep edhe të drejtën për transport mallrash brenda vendit për të tretë e me qira, si dhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit.

Për mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme, subjekti duhet të paraqesë edhe dokumentet sipas nenit 31.”.

Neni 9

1. Shkronja “h” e pikës 1 të nenit 3 dhe neni 39 i udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, shfuqizohen.

2. Shkronja “a” e pikës 3 të udhëzimit nr.1648, datë 16.8.1999 “Për llojet e mjeteve të mallrave që nuk kanë nevojë për licencë ose certifikatë, për kapacitetin e mjeteve me qira e për të tretë për licencim dhe për dokumentacionin e mjeteve që punojnë në transportin ndërkombëtar të mallrave”, shfuqizohet.

3. Licencat/autorizimet/certifikatat e lëshuara do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr.6, datë 29.4.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 10.10.2007 “PËR MODELET E
LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe ndryshimeve të udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licenceve, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licenceve, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, modelet e licenceve/certifikatave me numër 104, 108, 110, 111, 112, 204 dhe 211 ndryshohen sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Modeli i licencës me numër 113 shfuqizohet.
3. Licencat/certifikatat e lëshuara, sipas modelit para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____


LIQENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

**TRANSPORT UDHËTARËSH NË LINJË TË RREGULLT
NDËRQYTETËSE NDËRMJET QARQEVË**

I LËSHOHET :



Personit Juridik : _____

Administratori : _____

Me seli në : _____

Itinerari i linjës ndërqytetëse :

.....

Frekuenca :

.....

Oraret e nisjes dhe të kthimit :

.....

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Liçenca mbulon transportin rrugor ndërqytetës të udhëtareve në linjë të rregullt ndërmjet Qarqeve.
2. Transport i rregullt i udhëtarëve është shërbimi në linjë të rregullt i transportit me frekuencë dhe itinerare të pandryshuara, ku udhëtarët mund të merren dhe të lihen në vendqëndrime të përcaktuara më parë.
3. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
4. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
5. Me marrjen e kësaj Liçencë, shoqëria (transportuesi) mban përgjegjësi për zbatimin e grafikut dhe funksionimin e linjës sipas orareve të miratuara;
6. Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve Nr.7889/94, Nr.7663/93, Nr.8626/00 në të cilat përcaktohet:
 - *"invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me Dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës."*
 - si dhe për zbatimin e ligjeve nr.8098/96, Nr.8153/96:
 - *"të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimet që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas"*.

Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes.
7. Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin ndërqytetës, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të qëndrimit.
8. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - nuk plotësohen më kushtet e kërkuara si, reputacion i mirë, kompetencë profesionale, gjendje të pershtatshme financiare dhe zoterim të mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar.
 - subjekti transportues, nuk fillon veprimtarinë brenda 60 ditëve nga data e marrjes së liçencës, ose ndërpret veprimtarinë për më shumë se 45 ditë.
 - provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të fallsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____


LIÇENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

AGJENCI TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH

I LËSHOHET:



Personit Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. *Agjenci Transporti Ndërkombëtar Udhëtarësh*: personat juridike që iu shërbejnë udhëtarëve dhe bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim, me dhënie informacioni, pajisjeje me bileta, organizim udhëtimit dhe shërbime të tjera që lidhen me transportin, me qëllim mbërritjen e tyre të sigurt dhe në kohë në destinacionin e kërkuar.
2. Kjo licencë i jep të drejtë mbajtësit të saj të kryejë veprimtarinë e agjencisë së transportit të udhëtarëve i cili ka për detyrë:
 - të kryejë këtë veprimtari kundrejt kontratës së lidhur me shoqëritë e transportit sipas kërkesave të kodit civil për këtë shërbim.
 - tërheqjen e biletave të transportit të udhëtarëve dhe të faturave përkatëse nga Degët Rajonale të Tatimeve.
 - të afishojë dukshëm në vendqëndrimet e autobusëve linjën, vendin e nisjes dhe mbërritjes së autobusit, oraret përkatëse në nisje dhe mbërritje si dhe kushtet për transportin e bagazheve.
 - të shes dhe rezervojë biletat e udhëtarëve, sipas çmimeve të miratuara. Bileta të jetë e vulosur me emërtimin e transportuesit.
 - të pajisi me bileta transporti bagazhet e udhëtarëve.
 - të mbajë në mënyrë të rregullt të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre dhe të transportuesit të cilit i shërben, të ardhurat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe bagazheve, vëllimin e punës së realizuar gjatë transportimit të udhëtarëve, etj.
3. Kjo licencë jep të drejtën edhe për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për transport të brendshëm udhëtarësh dhe taksi, kur zyra e agjencisë ndodhet në vend të përshtatshëm për kryerjen e këtij lloji shërbimi, të vërtetuar me dokument nga Bashkia/ Komuna përkatëse.
4. Licenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
5. Licenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) ne te janë bere te palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - *emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;*
 - *nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;*
 - *data e fillimit dhe mbarimit te periudhës se vlefshmërisë;*
6. Licenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara si, reputacion i mire, kompetencë profesionale, gjendje te përshtatshme financiare.
 - provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.
 - shkelen detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

LIQENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR
TRANSPORT TE MALLRAVE ME MJETE JASHTË NORME

I LËSHOHET:

Personit Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Licenca i jep të drejtë mbajtësit të saj të bëjë regjistrimin e mjeteve jashtë norme.

Licenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Liçenca i jep të drejtën mbajtësit të saj të kryejë veprimtarinë e transportit të mallrave me mjete jashtë norme.
2. Konsiderohet jashtë norme mjeti që i kalon, për kërkesa funksionale të veçanta, kufijtë e përmasave gabarite dhe kufijtë e ngarkesave të përcaktuara në nenet 61 dhe 62 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.
3. Liçenca i jep të drejtën mbajtësit të saj për të bërë regjistrimin e mjeteve jashtë norme.
4. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
5. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - *emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;*
 - *nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;*
 - *data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;*
6. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - Nuk plotësohen më kriteret bazë të liçencimit të përcaktuara sipas nenit 8 të Udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007.
 - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.
7. Liçenca në origjinal mbahet nga transportuesi. Një kopje e notëruar e liçencës duhet të mbahet në bordin e mjetit.
8. Liçenca duhet të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e autorizuar të kontrollit.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 Republic of Albania
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 Ministry of Public Works, Transport and Telecommunications
DREJTORIA E PERGJITHHME E SHERBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR
 General Directorate of Road Transport Services

LIÇENCË
 LICENCE

Nr. _____, datë ____/____/____
 No date

PËR
TRANSPORT NDËRKOMBËTAR MALLRASH PËR TË TRETË
DHE ME QIRA
 (for the international carriage of goods by road for hire or reward)

I LËSHOHET:
 ISSUED TO



Personit Fizik/ Juridik: _____
 natural/ juridical person:
Administratori: _____
 administrator:
Me seli në: _____
 trade address

Kjo liçencë lejon edhe ushtrimin e veprimtarisë së transportit të mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit si dhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit.

The holder of this licence is allowed to perform road haulage inland transport for hire or reward and on all transports for own account.

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____
 This license is valid until

Firma dhe Vula
 Signature and Stamp
e Autoritetit Kompetent
 of the Competent Authority

DISPOZITA TË PERGJITHSHME
GENERAL PROVISIONS

1. Transportuesi është i detyruar të zbatojë, në territorin e palës tjetër kontraktuese, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi, në mënyrë të vecantë ato që lidhen me transportin rrugor dhe qarkullimin.
(The carrier must, on the territory of the other contracting party, comply with the laws, regulations and administrative measures in force in that State, particularly with regard to transport and traffic).
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
(This licence is personal and non-transferable).
3. Liçenca është e pavlefshme kur *(The Licence is no more longer valid, when):*
 - a) I ka përfunduar afati i vlefshmërisë *(The term of validity is over),*
 - b) Në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:
(In it are either missing or no more legible the following specifications):
 - Emri i shoqërisë *(The name of company);*
 - Nënshkrimi dhe vula e Autoritetit Kompetent
(The signature and stamp of the Competent Authority)
 - Data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
(The starting and the ending date of the validity time period);
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
(The Competent Authority who has issued the License withdraws it, when):
 - Nuk plotësohen më kushtet e vendosura në Nenin 6 të Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998.
(No longer meets the conditions laid down in Article 6 of the Law no.8308, date 18.03.1998).
 - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e autorizimit.
(It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the license).
5. Liçenca në original mbahet nga transportuesi. Një kopje e noteruar e liçencës duhet të mbahet në bordin e mjetit.
(The original of the licence must be kept by the haulage undertaking. A certified copy of the license must be kept in the vehicle).
6. Liçenca duhet të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e kontrollit.
(The licence must be produced whenever required by an authorized inspecting officer).
7. Kjo liçence duhet të shoqërohet ose jo me leje kalimi bilaterale ose multilaterale, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të transportit rrugor të mallrave.
(The holder of this licence is obliged to be equipped or not with the bilateral or multilateral permit, under international agreements for carriage of goods by road).




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

LIÇENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË TE AGJENCISË
SPEDICIONERE

I LËSHOHET:



Personit Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. *Agjenci Spedicionere*: personi juridik ndërmjetës që planifikon dhe organizon transportin e mallrave dhe/ ose shërbimet e lidhura me të, në emër të dërguesit të mallit.
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
3. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmerisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhteme:
 - emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula perkatese;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmerisë;
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - Subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara si, reputacion i mirë, kompetencë profesionale dhe gjendje të përshtatshme financiare.
 - Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

ÇERTIFIKATË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

**TRANSPORT UDHËTARËSH NË LINJË TË RREGULLT
NDËRQYTETËSE NDËRMJET QARQEVE**

I LËSHOHET AUTOBUSIT:

Targa: _____

Marka: _____

Në përdorim të personit juridik: _____

Sipas Liçencës Nr. _____, date ____/____/____.

Itinerari i linjës:

.....

Frekuenca javore/ditore:

.....

Çertifikata është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Çertifikata për transport udhëtarësh me autobus në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet Qarqeve provon zotërimin e licencës për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
 2. Çertifikata mbahet në origjinal në bordin e autobusit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të kontrollit me kërkesën e tyre.
 3. Çertifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj tek një subjekt tjetër.
 4. Çertifikata është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - *emri i shoqërisë, targa e mjetit;*
 - *nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;*
 - *data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;*
 5. Çertifikata hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - Hiqet licenca në bazë të së cilës ajo është lëshuar.
 - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të fallsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.
 6. Me marrjen e kësaj Çertifikate, drejtuesi i mjetit mban përgjegjësi për zbatimin e grafikut dhe funksionimin e linjës sipas orareve të miratuara.
 7. Mbajtësi i Çertifikates mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve Nr.7889/94, Nr.7663/93, Nr.8626/00 në të cilat përcaktohet:
 - "invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me Dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës." si dhe për zbatimin e ligjeve nr.8098/96, Nr.8153/96:
 - *"të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimet që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas".*
- Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin ndërqytetës, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Republic of Albania
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR
General Directorate of Road Transport Services

ÇERTIFIKATË
CERTIFICATE

Nr. _____, **datë** ____/____/____
No date

PËR

**TRANSPORT NDËRKOMBËTAR MALLRASH PËR TË TRETË
DHE ME QIRA**

(for the international carriage of goods by road for hire or reward)

I LËSHOHET:

Issued to

Targa:

Number plate

Marka:

Make/type

Në përdorim të personit fizik/juridik: _____

To be used by the natural/ juridical person

Sipas Liçencës Nr. _____, datë ____/____/____.

By of the licence No. date

Kjo Çertifikatë është e vlefshme edhe për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit si dhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit.

This certificate is also valid for the inland transport of goods by road for hire or reward and on all transports of goods for own account.

Çertifikata është e vlefshme deri më datën ____/____/____

The certificate is valid until

Firma dhe Vula
Signature and Stamp
e Autoritetit Kompetent
of the Competent Authority

DISPOZITA TË PERGJITHSHME
GENERAL PROVISIONS

1. Transportuesi është i detyruar të zbatojë, në territorin e palës tjetër kontraktuese, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me transportin rrugor dhe qarkullimin.
(The carrier must, on the territory of the other contracting party, comply with the laws, regulations and administrative measures in force in that State, particularly with regard to transport and traffic).
2. Çertifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj tek një tjetër.
(The certificate is personal and non-transferable).
3. Çertifikata është e pavlefshme kur *(The Certificate is no more longer valid, when):*
 - a) I ka përfunduar afati i vlefshmërisë *(The term of validity is over)*,
 - b) Në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:
(In it are either missing or no more legible the following specifications):
 - Emri i shoqërisë, targa e mjetit *(The name of company, number plate of vehicle);*
 - Nënshkrimi dhe vula e Autoritetit Kompetent
(The signature and stamp of the Competent Authority)
 - Data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
(The starting and the ending date of the validity time period);
4. Çertifikata hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
(The Competent Authority who has issued the Certificate withdraws it, when):
 - Hiqet liçenca në bazë të së cilës ajo është lëshuar.
(The licence on the basis of which it is issued, is withdrawn)
 - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e çertifikatës.
(It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the certificate).
5. Çertifikata në origjinal mbahet në mjet dhe paraqitet sa here kërkohet nga inspektorët e kontrollit. *(The original of the certificate must be kept in the vehicle and must be produced whenever required by an authorized inspecting officer).*
6. Ndalohet transporti mallrave ndërmjet dy pikave brenda territorit të palës tjetër kontraktuese.
(It is forbidden the carriage of the goods from a point to another point in the territory of the other contracting party).

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.5.2008
Doli nga shtypi më 21.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë